



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 18621 prot.
3

Memaliaj më 29.08.2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 29.08.2025 në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e parë të bashkisë Memaliaj.

Ora e fillimit të mbledhjes 10:15.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e fillimit të mbledhjes 10 Këshilltarë.

Kryesuesi i mbledhjes Z.Erjon Sinanaj/ Kryetar këshilli.

Përshëndetje të nderuar këshilltarë! Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Siç jeni në dijeni vazhdon e njëjta situatë ashtu si dhe në muajin e korrik, administrata nuk ka protokolluar asnjë material, projekt vendimet për 6% dhe ndihmën për familjet në nevojë. Sipas planit të punës ne po vijojmë punën dhe rendi i ditës ju është dërguar dhe ju jeni në dijeni. Administrata nuk la kthyer asnjë përgjigje ndaj kërkesave tona. Kështu që arsyet i dinë vet ata.

Po ju njoh me rendin e ditës.

Irena Jaupi: Dua të pyes para se të kalojmë te rendi i ditës. Ka ndonjë justifikim nga administrata pse është kjo situatë?

Erjon Sinanaj : Ju jeni në dijeni të kërkesës sonë për interpelancë Kryetarit të Bashkisë dhe ai nuk u paraqit në mbledhje dhe nuk dërgoi as ndonjë prej nënkryetarëve siç e parashikon ligji as nuk na ka dërguar ndonjë shkresë justifikuese për arsyen e mosparaqitjes. Me sa jam vënë në dijeni nga këshilltarët u ka shkuar një shkresë ku ata thonë se nuk sjellin materiale pse kryesia sepse kryesia nuk zhvilloi një mbledhje jashtë radhe.

Irena Jaupi: Mbledhja bëhet për të kaluar vendime për komunitetin, gjatë kësaj kohe nuk ka kaluar ndonjë gjë për këshilltarët.

Erjon Sinanaj: Pikërisht është një shkelje nga ana e administratës dhe ne nuk mund të përgjigjemi për këtë e dinë vetë ata.

Irena Jaupi: Duhet sqaruar komuniteti se ne jemi këtu duke kryer detyrën. Këshilli është gati për t'i shërbyer komunitetit. Materialet s'janë kjo duhet të bëhet e qartë.

Erjon Sinanaj: Vazhdojmë me rendin e ditës. Lexon rendin e ditës.

Asqeri Muçoima: Doja të shtoja në rend dite dhe një pikë tjetër për shfuqizimin e atij vendimi për ndërprerjen e pagës së këshilltarëve se nuk e shoh të bazuar në ligj që drejtori i financës të ndalojë

pagesën pasi ligji e thotë qartë pas 6 muajve mosparaqitje këshilltarit i hiqet mandati. Nuk mund të na vendosin sanksione pasi kryetari i këshillit që është titullari ynë e ka çuar listë prezencën të plotë.

Nuk mund të vsendosen sanksione nga administrata pasi pas 6 muajve hiqet mandati i këshilltarit e thotë ligji. Meqenëse e mora fjalën dua të shpreh indinjatën time të thellë për sjelljen e Kryetarit të Bashkisë sepse është e pafalshme që ka dy muaj rresht që administrata nuk sjell projekt vendime e relacione, për komunitetin, jo për këshilltarët e theksoj. Unë kam qenë ai që e kam kërkuar që në fillim që mbledhjet e Këshillit të ishin live dhe ia kam thënë edhe Kryetarit të Bashkisë këtu ,ti or djalë flet kështu, vepron kështu sepse ke fatin e mirë se ne nuk jemi live , të na dëgjonte populli ,se po të na dëgjonte populli, do të sillej ndryshe ai. Ata të 6% dhe ndihmës ekonomike që jepen venë te ai dhe ai e ka gjetur gozhdë ,thotë nuk e kalon këshilli dhe kjo nuk është aspak serioze dhe për bashkinë dhe për kryetarin e bashkisë. Le ta marri vesh komuniteti i bashkisë Memaliaj se ne i kemi kaluar të gjitha çfarë ka sjellë bashkia. Kuptohet ka pasur dhe raste vërejtjesh janë korrigjuar dhe janë miratuar.Kemi qenë të paktën dhe unë ,por dhe këshilltarët shumë bashkëpunues me kryetarin e bashkisë dhe me administratën e bashkisë edhe kur kemi kërkuar dokumentacionin, sepse po të marrësh dokumentacionin e bashkisë tonë ,dalin plotë,dalin si paçavure ato dokumentat, por i kemi kërkuar që bashkia të jetë e rregullt e nuk jemi nisur fare nga bindjet politike por si përfaqësues të komunitetit dhe po punojmë për komunitetin. Kam dhe këtë tjetrën kryetari i bashkisë është dhe anëtar i Këshillit të Qarkut ,unë nuk e di çfarë prët këshilli i qarkut kur ka këtë situatë dy mujore që nuk paraqiten dokumenta .Çfarë prët Këshilli i Qarkut? Çfarë prët? Kryetari I bashkisë është dhe në një fare varësie për zbatimin e ligjshmërisë nga prefekti I qarkut.Çfarë prët Prefekti?Pse nuk vjen të komunikojë me Kryetarin e bashkisë?Pse nuk vine këtu në këshill?Pse nuk e marrin Kryetarin e Bashkisë,bashkë me të ,të vine këtu se është e pafalshme se në interpelancë venë ministra e kryeministra në gjithë botën dhe të mos vij Kryetari I bashkisë në interpelancë me këshillin. Kjo është e habitshme,është e papranueshme ,është dhe mungesë respekti dhe n.q.se ai kërkon bashkëpunim nga ne,ky është bashkëpunimi.Eja në këshill dhe të bashkëpunojmë.

Kryetari/Erjon Sinanaj: Shumë e drejtë dhe të falenderoj për fjalën por duhet të mbetemi te procedura.

Esmerald Xhemali:Për procedure në lidhje me propozimin që bëri profesori nuk e shoh të arsyeshme të futet në rend dite në këtë mbledhje sepse duhet mbledhur komisioni dhe duhet përgatitur një relacion sepse ne se njohim fare se ç'vendim është ai,ç'përmbajtje ka dhe ku është mbështetur në ligj apo në rregullore që ta fusësh që sot në rend dite .ta diskutosh e shfuqizosh duhej të ishte mbledhur komisioni më parë,kështu që propozoj ta lëm për mbledhjen tjetër.Irena Jaupi: Unë dua të bëj një pyetje meqenëse kemi dhe koordinatorin e BtF Z.Albert Kasi.Ky vendim ,a ka fuqi?

Albert Kasi: Pushteti vendor është në vazhdimësi ,ligji thotë që këshilltari paguhet me 10% të pages së kryetarit të bashkisë.,po nuk u paraqit 6 muaj rresht I hiqet mandate i këshilltarit.Most të vine 6 muaj si i bëhet ?

Irena Jaupi :Pyetja e dytë:Po ligji thotë dhe ai vendim ,kshilltari duhet të marri pjesë patjetër pjesë në një aktivitet gjatë muajit ,komision,takim me qytetarët,Quhet aktivitet?A I ndërpritet pagesa këshilltarit nëse i ka kryer të gjitha këto?

Albert Kasi:Vendimi është i juaji.Ligji thotë për një aktivitet dhe mbledhja e komisionit është punë.I ka shkuar listëprezenca kryetarit të bashkisë e plotë.Nga e di ai kush mungon?pagesa është për punën jo për një mbledhje.

Erjon Sinanaj;Kryetari I bashkisë është mbështetur te procesverbali I mbledhjes jo te listëprezenca e dërguar e firmosur nga ana jonë.

Irena Jaupi:Disa prej nesh janë në dy komisione.Nuk quhen këto veprimtari këshilli?

Albert Kasi, koordinator i BtF: Unë e kam lexuar rregulloren dhe ajo nuk ka sanksione, paga është për gjithë muajin dhe jo për një mbledhje. Këshilltari ka takime e ka më shumë se një komision.

Esmerald Xhemali: a ka aktivitete më të rëndësishme se mbledhja e kryesisë që mirastohet rendi i ditës?

Erjon Sinanaj: Ai vendimi thotë qartë nëse nuk ka marr pjesë në një aktivitet gjatë muajit ndërpritet shpërblimi. Profesor propozimi juaj do të kalojë për herën tjetër.

Flamur Mushamati: Z. Albert si koordinator që je kasha një pyetje: a kemi të drejtë ne si këshilltarë ta shfuqizojmë atë vendim?

Albert Kasi: po.

Hidhet rendi I ditës në votim pa ndryshime.

Vota Pro 10 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Miratimi I procesverbalit të mbledhjes së datës 30.07.2025 dhe datës 15.8.2025.

Vota Pro 10 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Projekt vendim: Për zgjedhjen e nënkryetarit të Këshillit Bashkiak Memaliaj.

Erjon Sinanaj/Kryetari. Nisur nga diskutimi I mbledhjes së kaluar për plotësimin e vakancës së nënkryetarit i cili i përket opozitës dhe sot do të bëhet zgjedhje e nënkryetarit më parë fjala për komisionin e mandateve.

Irena Jaupi: Në emër të komisionit ju bëj me dije se jemi mbledhur. Ku kryetari I grupit të opozitës z. Xhevit Kacorri ka dale me një propozim me emrin e Znj. Arsola Muzha për nënkryetare.

Esmerald Xhemali: Në grupin e këshilltarëve na është dërguar një ankesë e bërë nga kryetari i PD z. Bujar Kapllani, i cili i drejtohet këshillit në lidhje me zgjedhjen e nënkryetarit, procedurën e pretendime të kësaj natyre. Pyetjen e kam për grupin BF: A jeni mbledhur ju si grup me kryesinë e partisë për të diskutuar? Subjekti ka dijeni, kryetari i partisë e di për kryetarin e grupit të këshillit, kush është?

Flamur Mushamati: Unë kam ardhur më vonë në këshill.

Esmerald Xhemali: Pyetja ime është për grupin dhe njëherë grupi BF jeni 4 anëtarë dhe keni kryetar Xhevitin, e gjitha konsiston për të shmangur këto shkresat e pakuptimta nga kryetari i PD-së.

Kërkesa i drejtohet këshillit, pra secilit prej nesh. Nëse Xheviti nuk do të ishte me ju do të kishte tre grupe këshilli sepse do të bashkohej me dy këshilltarët që nuk janë grup për shkak të numrave.

Irena Jaupi: Deri dje në emër të grupit ka folur Xheviti, dhe ka marrë fjalën sa herë ka pasur diskutim dhe nuk e ka kundërshtuar njeri se nuk është kryetari i grupit BF.

Lauresha Lila: Meqë bëhet fjalë për grupin unë nuk kam qenë dhe nuk e di, sepse nuk kam qenë në mbledhjet e para, me rregullore duhen edhe përfaqësuesit e opozitës. E kjo nuk është shkelje?

Arsola Muzha: Nuk është shkelje po z. Bujar të citojë 3 veta kur ai ka qenë pjesë e këshillit dhe e ka propozuar Xhevitin si kryetar grupi, tani si e nxirrni Xheviti jashtë dhe ne s'dimë gjë.

Flamur Mushamati: Nuk mund të na përfaqësojë ai neve.

Erjon Sinanaj: Kur janë formuar grupet politike të këshillit janë paraqitur dy grupe: PS dhe BF ku e kanë firmosur që Xheviti është anëtarë i grupit BF dhe grupi BF e ka zgjedhur si kryetar?

Flamur Mushamati: Unë se njoh Xhevitin për kryetar grupi prandaj propozoj për grupin tim Lauresha Lilën si kandidate për nënkryetare këshilli.

Irena Jaupi: Z. Falmur, kam një pyetje: Ju thoni se nuk ke qenë, kur është zgjedhur kryetari i grupit. Në mbledhjet pasardhëse në diskutimet e bëra z. Xhevit ka marrë fjalën dhe ka mbajtur qëndrim në emër të grupit. Pse nuk e keni kundërshtuar ju?

Lauresha Lila: Keni të drejtë për këtë pjesë. Ne nuk kemi kundërshtuar ngaqë e kanë vënë ata para nesh.

Erjon Sinanaj: Xhevit Kacorri është njohur si kryetar grupi në çdo mbledhje, kur unë i kam dhënë fjalën nuk e ka kundërshtuar njeri, prandaj e mbyllim këtë diskutim. Në bazë të procedurës të hidhen në votim dy kandidaturat, ngrihet komisioni i votimit.

Petrit Lumani: Jemi para fakati që do zgjidhet nënkryetari dhe di që i takon grupit BF. Shqetësimi i atij kryetarit të partisë që po t'i dhimbsej grupi le të rrinte këtu, po sigurisht i pëlqeu atje dhe iku, kurse sot këta janë paqartë. Nuk e di vet Xhevit e ka propozuar pa dijeninë e grupit.

Erjon Sinanaj: Jemi në mbledhje të këshillit dhe nuk mund të diskutojmë problemet e brendshme të grupit BF. Viojmë me ngritjen e komisionit të votimit.

Asqeri Mucoima: Propozoj P. Lumanin nga grupi PS.

Lauresha Lila: Propozoj F. Mushamatin nga grupi BF.

Irena Jaupi: Propozoj B. Mamajn.

Komisioni përbëhet nga:

1- Flamur Mushamati/ Kryetar

2- Petrit Lumani/ Sekretar

3- Bujar Mamaj

Votimi bëhet i fshehtë.

Komisioni firmos fletët e votimit dhe fillon procesi i votimit duke thirrur këshilltarët sipas listës emërore. Komisioni dorëzon në përfundim procesverbalin dhe fletët e votimit ku del se nga votimi rezulton si më poshtë:

Kryetari njeh këshillin me rezultatin e votimit.

1- Arsola Muzha 8 vota

2- Lauresha Lila 2 vota

Nga rezultati del se kandidatura fituese është znj. Arsola Muzha me 8 vota. Urime!

Procesverbalet të administrohet nga sekretari.

Kalohet te pika katër e rendit të ditës.

Duhej të kishte ardhur materiali për masat e marra për përgatitjen e ambienteve shkollore për vitin 2025-2026. Meqë nuk kemi material, nuk kemi çfarë të diskutojmë.

Irena Jaupi: Ne duhet të dimë patjetër kë të informojmë nuk di si do ta marrim informacionin.

Erjon Sinanaj: Shkresa ka vajtur nga sekretaria sipas planit të punës.

Flamur Mushamati: Nuk tolerohet ky ngerç për mosfunksionimin e këshillit se ne nuk kemi projekte dhe nuk po marrim vendime, ky ngerç është i rëndë, ne sot nuk u shërbejmë qytetarëve.

Erjon Sinanaj: Këshilli po funksionon se është mbledhur nuk ka sjellë administrata materiale.

Flamur Mushamati: Unë propozoj që kryetari i këshillit të ulet me kryetarin e bashkisë dhe të gjejnë një zgjidhje, kryesia të sheshojë problemet dhe të gjejë një zgjidhje.

Irena Jaupi: Ne e kërkuam o Falmur në mbledhjen e kaluar dhe nuk u paraqit njeri. Ne kemi të drejtë të gjithë pse po bëhet kjo shkelje.

Flamur Mushamati: Për arsye se nuk u zhvillua mbledhja jashtë radhe, fillimisht kjo më është thënë.

Arsola Muzha: Thirrja për interpelancë nuk është kërkesë për bashkëpunim.

Erjon Sinanaj: Në datën 15 gusht ku dhe ju ishit të pranishëm e pritëm kryetarin e bashkisë dhe ai nuk erdhi dhe as dërgoi dikë tjetër. Ne e morem iniciativën të gjithë si këshill për të diskutuar.

Petrit Lumani: Dhe unë kam bërë përpjekjet e mia për të takuar punonjës të institucionit po me kanë thënë se jam në adresë të gabuar. Po shembulli im është i tillë se jam këshilltar. Ok. Kryetari është kryetar e ka detyrat e tija po nuk e kuptoj këta punonjës që nuk reagojnë të bëjnë punët e tyre, janë funksionare dhe paguhen. Unë nuk mendoj në rang kryesie, por vemi të gjithë te zyra e tij.

Esmerald Xhemali: Une jam dakord me mendimin e profesorit.

Irena Jaupi: Komuniteti duhet ta dijë që pengesat nuk i vijnë nga këshilli. Nuk po na vijnë informacioni që dihet të sjelli në keshill relacione e projekt vendime.

Asqeri Muçoima: Rasti i Lekës është rast i veçantë jo si rastet e tjera që kemi shpërblyer. Qytetarja ka bërë kërkesën që në 2024.

Të kenë guximin dhe kurajon ti kthejnë përgjigje pse nuk e kanë trajtuar sepse ligji e parashikon. Në qytetin tonë ndodhi masakër dhe bashkia të mos merret me këtë rast është e pafalshme. Irena Jaupi:

Duhet të kemi dhe ne një informacion pse nuk na kanë sjellë një relacion për këtë rast.

Anest Haliali: Para dy muajsh na erdhën në këshill dhe ne i kemi kaluar, nuk kemi kthyer asnjë rast për ndihmë financiare.

Erjon Sinanaj: Kërkesa e Znj/Leka Çela që u paraqit para se të fillonte mbledhja u regjistrua në procesverbal.

Mbledhja deklarohet e mbyllur nga kryetari i këshillit.

Këshilltarë pjesëmarrës:

1. Lauresha Lila
2. Flamur Mushamati
3. Arsola Muzha
4. Esmerald Xhemali
5. Erjon Sinanaj
6. Petrit Lumani
7. Asqeri Muçoima
8. Irena Jaupi
9. Anest Halili
10. Bujar Mamaj

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka



Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj

